



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LIGJ

Nr. 136/2020

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2019**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 158, të Kushtetutës, dhe të nenit 63 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

**Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit**

Miratohet raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit për vitin 2019, sipas dokumenteve të mëposhtme, pjesë përbërëse të tij:

- a) pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit për vitin 2019;
- b) raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2019 në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij për vitin 2019;
- ç) raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës për vitin 2019;
- d) raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit 2019.

Neni 2

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 16.11.2020